

URDHËR
Nr. 215, datë 1.8.2025

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe në zbatim të neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 21, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; si dhe të nenit 30, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, për shkak të lejes vjetore të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së përfaqësimit të institucionit në marrëdhëniet me palët e treta, znj. Alketa Çeli, Sekretare e Përgjithshme e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për periudhën 4.8.2025 deri më 20.8.2025.
2. Znj. Alketa Çeli nuk mund ta nëndelegojë këtë kompetencë.
3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Sokol Çomo